



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 143

Prishtinë, më 1.4.2014, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Faton Topalli, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Ramiz Lladrovci, Nijazi Idrizi.
Mungoi : Boban Todorović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 25.3.2014,
3. Raporti vjetor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2013.
4. Konfirmimi për leximin e dytë për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimi i bujqësisë,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.3.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25 mars 2014 duke shtuar fjalën ”sipas Udhëzimit administrativ” në deklaratën e **Sevdije Lamës** në pikën të ndryshme tek licencimi i arçitektëve dhe ndërtimtarëve.

3. Raporti vjetor i Agjencisë për komplekse memoriale

Kryetari Nait Hasani përshëndeti z. **Idriz Blakaj** Drejtor i Agjencisë, të cilit fillimisht ja dha fjalën, në mënyrë që pastaj të vazhdoi komisioni shqyrtimin e mëtejshëm. Drejtori raportoi duke theksuar se Agjencia ka punuar pa staf deri 12 janar 2014 kur janë bartur tre puntorë të premtuar nga MMPH, tani është edhe një asistente, ndërkaq janë lejuar 9 puntorë të ketë Agjencia pas intervenimit të tij në Komisionin për buxhet. Ai falënderoi për ndihmën e dhënë nga administrata e Kuvendit derisa nuk ishte stafi i cekur më lartë. Në vazhdim ai më tepër ishte kritik në vetë Agjencinë përkatësisht MMPH sesa që raportoi për punën e bërë, ngase sipas tij nuk dihet pse është themeluar agjencia, pasi që nuk barten projektet nga MMPH të miratuara në këtë Komision parlamentar dhe në mbledhjen plenare me rastin e miratimit të Ligjit për këtë Agjenci, përveç projektit të Prekazit, i cili ka qenë vazhdimësi, mirëpo parashtrohet pyetja logjike : a nuk janë edhe projektet tjera vazhdimësi, pse ndodhë kështu, pse dy ciceronët mbesin as andej as këndeji nuk di por dyshoj se ka korrupsion, përfundoi ai dhe kërkoi më tepër angazhim nga ky komision në këtë drejtim.

Kryetari Nait Hasani vlerësoi raportin e drejtorit dhe shprehu besimin se në vazhdim kjo agjenci ende do të konsolidohet me anë të akteve nënligjore por edhe me përmbushjen e obligimeve të mbetura për staf etj, ndërkaq lidhur me bartjen e projekteve nga MMPH tha se ato nuk barten për shkak se janë të kontraktuara, kurse të rejtat i barten agjencisë. Për problemet tjera kryetari rikujtoi drejtorin se i njejtë ka shfaqur gadishmëri kur ka marr këtë funksion se do të përballet me sfidat ekzistuese.

Faton Topalli : ju thatë se në fillim buxheti ishte 3 milion, menjher pastaj u bë 1 milion, pse ky ndryshim i menjihershëm, a keni sqarim ?

Salih Morina : ju sqaruar për jo bartjen e projekteve dhe shpalljen e tenderave nga MMPH gjatë muajit dhjetor, a keni biseduar me MMPH pse ka ndodhë kjo përzierje e kompetencave kur dihet se me ligj është dashur të bartet buxheti te agjencia ?

Afërdita Berisha prej cifrave që po i shoh në tabela shuma 541.000 euro është pak e lartë, ku u shpenzuan këto të holla ?

Ramiz Lladrovi fillimisht ju drejtua stafit me pyetjen a incizohet kjo mbledhje ngase është obligim ligjor (stafi u përgjigj se nuk është problem incizimi ngase diktafonat janë siguruar për çdo komision, por obligimi sipas Rregullores për incizim është vetëm për dëgjime publike dhe mbledhje plenare) për shkak se drejtori prezent përmendi që ka korrupsion apo dyshon për këtë (ndërhyri Drejtori **Blakaj** dhe tha se ka folë për dyshim). Mosbartja e projekteve në agjenci dhe informatat tjera nga drejtori, vazhdoi ai, duhet të janë informata për prokurori e jo për komision, gjithashtu këto informata duhet të janë të sakta e jo dyshime, në anën tjetër ky nuk ka mujt me kry prokurimin pa puntorë ose vetëm me dy puntorë, përkatësisht pa pasur komision. Ky raport nga kjo agjenci, vazhdoi, ose duhet të miratohet ose të tregohet qartë çka dëshirohet në punën e mëtejme. Ai më tutje konstatoi : kushtueshmërinë e lart të projektit të ujit për gjelbrim për Prekaz, ciceronët ose duhet ti largoni ose ti merrni nën ombrellën e juaj, të gjitha projektet duhet të miratohen me organogram.

Sevdije Lama : ministria e financave këtu në raport konstaton se nuk ka buxhet, nuk ka bartje, nuk është kjo nuk është ajo, atëher pse u themelua kjo agjenci e cila qe tetë muaj nuk ka bërë asgjë ?

Nijazi Idrizi : mendoj se kemi të bëjmë me një raport të singert por i kam disa dilema p.sh. tenderi në dhjetor a është shpallur apo mbyllur, kurse bartja e projekteve me vazhdimësi apo pa të, pse kjo kështu ?

Drejtori Idriz Blakaj duke u përgjigjur pyetjeve një nga një tha se periudha raportuese nuk ka të bëjë me një vit ndërsa ligji i miratuar thotë se drejtori nënshkruan aktet nënligjore (ndërhyri

Ramiz Lladrovci dhe tha se nuk kërkohet raport për këtë vit), pastaj theksoi se tërë vitin 2013 ka qenë i vetëm dhe nuk ka pasur mundësi ti kryej punët, në pyetjen e z. Topalli u përgjigj se tri herë është ndrruar buxheti, tek pas intervenimit të fundit janë lejuar 1 milion dhe 9 puntorë për këtë agjenci. Ministria e financave dhe mjedisit kanë biseduar por tre milionshi është kthyer në një milion për shkak se janë kthyer projektet. Më tutje vazhdoi me përgjegjen për projektin e ujit i cili do të kushtoi afër 800.000 euro për shkak se janë 14 km në pyetje, kurse rreth punëve në vazhdim ai konstatoi që ndoshta nuk kryhen edhe 20 vite me radhë. Lidhur me pyetjen pse vetëm projekti i Prekazit është bartur, edhe ai tha se ka plot dyshime për korrupsion, ndërhyri **Ramiz Lladrovci** dhe konstatoi se drejtori mund të tregoi trimnin por korrupsioni ose ekziston ose nuk ekziston, nuk mund të thuhet dyshoj, ndaj kërkoi prej komisionit të deklarohet për këtë pjesë të raportimit. Lidhur me ciceronët dhe organogramin drejtori tha se nuk ka buxhet për ata dhe u pajtua se është marri të mbahen ata me vetfinancim, ndërsa organogrami është dërguar në MAP për miratim.

Kryetari Nait Hasani duke pasur parasysh lartcekurat sugjeroi komisionin të ftohet ministri i MMPH dhe drejtori për mbledhjen e radhës, ndërsa komisioni pasi që diskutoi edhe për përgjegjen e ministrit të bujqësisë rreth rregjistrimit të bujqësisë u pajtua dhe nxori :

P Ë R F U N D I M

Për mbledhjen e radhës :

- 1. Të ftohet Ministri i MMPH në orën 11,00 rreth zbatimit të Ligjit për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës (dilemave në mes Agjencisë dhe MMPH rreth komplekseve memoriale),**
- 2. Të ftohet Ministri i Bujqësisë në orën 12,00 rreth datës së mbajtjes së regjistrimit të bujqësisë, ngase ky komision duhet të procedoi Projektligjin për leximin e dytë,**
- 3. Të diskutohet sugjerimi i Sevdije Lamës për vizitë në 7 komuna kryesore të Kosovës rreth zbatueshmërisë së Ligjeve për Ndërtimet, Këshillimoret dhe Komasacionit.**

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani